



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 30 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1103, datë 20.1.2023	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në pronësi të Shoqërive Huamarrëse në Administrim..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1103/1, datë 20.1.2023	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara..... 3
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 20, datë 23.1.2023	Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare, lidhur me projektet në fushën e turizmit..... 4
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 513, datë 25.1.2023	Për shprehje interesi të kandidatëve të interesuar për t'u zgjedhur anëtarë në Bordin Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë..... 9
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 577/1, datë 26.1.2023	Për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme..... 10
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 351, datë 30.1.2023	Për shpalljen e 2 (dy) vendeve vakante për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 11

**NJOFTIM**

Nr. 1103, datë 20.1.2023

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË PRONËSI TË
SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË
ADMINISTRIM**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1673, datë 21.12.2008, “Caktimin e rregullave për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në pronësi të Shoqërive Huamarrëse në Administrim

Nr.	Emërtimi	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
			Data	Ora	Vendi
1	Fiat Albea	21 952	22.2.2023	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Shoqërive Huamarrëse në Administrim.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)		Sipër-faqja e përgjithshme (m ²)	Sipër-faqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Bodrum me nr. 5/56-B2	Shëngjin, Lezhë	225 159,2	225 159,2	11.6		22.2.2023	11:00	DDPP

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, pasi të keni tërhequr pranë tyre faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 1103/1, datë 20.1.2023

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË
PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
TË KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me çmim 50% më të ulët se çmimi fillestar i ulur me 30%, si më poshtë:



2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)		Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Bodrum me nr. 5/56-B3	Shëngjin, Lezhë	225 159,2	225 159,2	11.6		22.2.2023	11:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. **Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës**, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

URDHËR Nr. 20, datë 23.1.2023

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË APLIKIMIT DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE, LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar; të pikave 8 dhe 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të aplikimit për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri, aneksi I.

2. Miratimin e procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri, aneksi 2.

3. Publikimin e procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare, në lidhje me projektet në fushën e turizmit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

4. Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Turizmit, si dhe Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Buxhetit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi



NJOFTIM

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR
PËRFITIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE TË PROJEKTEVE NË
FUSHËN E TURIZMIT**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, privatë ose publikë, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, në funksion të realizimit të misionit strategjik:

“Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”

Thirrja synon promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike për zhvillimin e turizmit malor, natyror, kulturor, tradicional, kulinar, ekoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës etj., në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik për vitin 2023.

Thirrja do të qëndrojë e hapur nga data **23 janar deri më datën 21 shkurt të vitit 2023**. Projektet duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, gjatë periudhës 14.3.2023 deri më 15.11.2023.

Tematika e thirrjes për mbështetje financiare të Projekteve në Turizëm është:

- Promovimi i destinacioneve dhe zhvillimi i produkteve turistike.

Atraksionet turistike prezantohen dhe lidhen me një sërë tiparësh dalluese materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie, që përfshin trashëgiminë historike dhe zonat kulturore, gastronominë, letërsinë, industrinë krijuese dhe kulturat e gjalla me stilin e tyre të jetesës, sistemet e vlerave, besimet dhe traditat.

Promovimi i destinacioneve turistike dhe i vlerave të veçanta lokale, nëpërmjet zhvillimit të eventeve tradicionale dhe inovative të aktivitetit shpirtëror njerëzor, motivon pjesëmarrjen aktive të turistëve në përvojat shqiptare, atraksionet dhe potencialet e prekshme dhe të paprekshme të destinacioneve turistike.

ANEKSI I

**FORMULARI I APLIKIMIT
PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË
FUSHËN E TURIZMIT**

**PJESA I
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

Titulli i Projektit			
Prioriteti i thirrjes ku aplikohet	PRIORITETI 1 (klikë kutinë)	☐	PRIORITETI 2 (klikë kutinë)
Emri i aplikantit			
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.)	Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në gjykatë		
	NIPT-i		
	Emri i bankës		
	Numri IBAN		
	Nr. i llogarisë bankare (në lek)		
Adresa:			
E-mail			
Website			
Nr. tel.			
Kohëzgjatja e Projektit	<datë/ muaj nga/ deri>		



Vendi/et ku zbatohet Projekti	
Personi i kontaktit	
Funksioni	
Buxheti total	
Fondet e kërkuara nga MTM-ja	
Informacion për bashkëfinancim	
Partnerët e Projektit	

PJESA II PËRSHKRIMI I PROJEKTT

Titulli i Projektit:

Qëllimi i Projektit: Përshkruani shkurtimisht Projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si Projekti u përgjigjet nevojave të identifikuar (maksimumi 10 rreshta).

[Shpjegoni ...]

Objektivat e projektit (maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv):

1. [Shpjegoni ...]
 2. [Shpjegoni ...]
 3. [Shpjegoni ...]
- Etj.

Aktivitetet kryesore të Projektit (maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuar në çdo fushë)

1. [Shpjegoni ...]
 2. [Shpjegoni ...]
 3. [Shpjegoni ...]
- Etj.

* Plotëso: Tabelën për aktivitet/nëaktivitetet e Projektit

Aktiviteti (përshkrimi)	Qyteti	Vendi/ data/ora	Periudha	Fusha/ gjinia	Nr. i audiencës (parashikim)	Nr. i personave të angazhuar (pagesa honorar)	Partneri zbatues

Shënim:

- Ju lutem, shënoni **aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkojnë.

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblodhur, se cili është grupi parësor i synimit të Projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e Projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Qëndrueshmëria e Projektit – Impakti afatgjatë i Projektit nga pikëpamja e problematikës

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (Maksimumi 5 rreshta):

[Shpjegoni ...]

A është Projekti/prodkti objektivisht i verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve (maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Projekti/prodkti rezultatet e pritura dhe treguesit lidhur me: [Shpjegoni ...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni ...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni ...]

së adresuar, fushës së zhvillimit të Projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e Projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]



PJESA III PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve.
(Përshtetshë natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve, duke përshtetur procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e Projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Partneri 1 (aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës suaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Struktura. Përshtetshë strukturën e organizatës, duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni ...]

Partneri 2

Emri i organizatës: [Shpjegoni ...]

Personi i kontaktit: _____

E-mail: _____

Adresa: _____

Faqja në internet: _____

Etj.

PJESA IV BUXHETI

Lutemi të përshtetshë shpenzimet e përfshira për implementimin e Projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Emri i aplikantit:

Titulli i Projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në Lekë	TOTAL	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZERAVE PËRKATËS									
1	Titulli i shpenzimit 1								
	<i>Shembull: Promocion dhe përgatitje (ftesa, poster, baner, programi) të specifikuar sipas përshkrimit të eventit dhe vendit</i>								
1.1	Dizajni i ftesës								
1.2	Printime	cope	100	200.00	2,000.00				
1.3	etj.								
	TOTAL 1			200.00	2,000.00				
2	Titulli i shpenzimit 2 (shembull Realizimi i aktivitetit)								
2.1	Shpenzime salle								
2.2	Shpenzime akomodimi								
2.3	etj.								
	TOTAL 2			-	-				
3	Titulli i shpenzimit 3								
3.1									
3.2									
etj.									
	TOTAL 3			-	-				
4	Titulli i shpenzimit 4								
4.1									
4.2									
etj.									
	TOTAL 4			-	-				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (në Lekë dhe në %)								



Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet.

Sqarim:

- Ju lutemi, të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe vetë aplikantin, si % e buxhetit total për Projektin.

- Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular, duhet të jenë të përcaktuara në LEK;

- Çmimet e parashikuara duhet të jenë me TVSH.

ANEKSI 2

PROCEDURAT PËR PËRFTITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT

Procedura e aplikimit bazohet në kriteret dhe afatet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

I. DOKUMENTACIONI

1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik, provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in, sa vijon:

a) vërtetim nga gjykata që nuk janë në proces falimentimi; dhe a/1. Vërtetim nga Zyra Përmbartimore se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbartuesit;

b) vërtetim nga gjykata që nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit; dhe b/1. Vërtetim nga gjykata nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) vërtetim nga gjykata; dhe c/1. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) që nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

ç) vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

d) vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me

legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

2. Dokumentacionin që demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të Projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, konkretisht:

- Kopje të certifikuara të balanceve të 2 (dy) vjetëve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

- Raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;

- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

3. Në formularin e aplikimit të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve, që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre, si dhe argumente që çmimet janë të bazuara në referenca.

4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e Projektit.

5. Aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) nëse aplikon si person fizik, duhet të paraqitet një CV dhe një portofol i veprimtarisë së aplikuesit;

b) nëse aplikon si person juridik, duhet të paraqitet një CV e subjektit dhe një portofol i veprimtarisë së tij të deritanishme;

c) vërtetim i llogarisë bankare të aplikantit;

d) konfirmim për bashkëfinancimin e Projektit të propozuar (nëse ka);

e) deklaratë e aplikuesit që nuk detyrohet për auditim ligjor të pasqyrave financiare (kur kjo është e aplikueshme).

** Kur aplikuesi është i huaj, ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kriteret e vendimit nr. 281, datë 13.4.2016, si dhe dokumentacionin e renditur më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.*

II. METODA E APLIKIMIT

Formulari i aplikimit i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës, duhet të dorëzohet dorazi ose me postë, brenda datës 21 shkurt 2023, pranë Protokollit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në adresën:

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1001, Tiranë
Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:



Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Aplikim për përfitimin e mbështetjes financiare në fushën e turizmit; emri i aplikantit; titulli Projektit.

Sqarojmë se dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të tërhiqet, por në rast interesi iu vihet në dispozicion fotokopja e tij.

III. FINANCIMI

Thirrja për përfitimin e mbështetjes financiare për vitin 2023, në kuadër të zhvillimit të programeve në fushën e turizmit, financohet nga fondi buxhetor i miratuar për vitin kalendarik.

Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të Projektit të pranuar e të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektet për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I KËRKESËPROPOZITIMEVE

Vlerësimi do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325 datë 31.5.2018, “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”.

Komisioni klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit brenda 8 (tetë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30-ditor (tridhjetëditor) të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesëpropozime për mbështetje financiare. Procesi i përzgjedhjes së kërkesëpropozimeve kryhet në fazat e mëposhtme:

- Vlerësimi i personit fizik/juridik dhe i dokumentacionit të dorëzuar për plotësimin e kriterëve;

- Vlerësimi i përmbajtjes së Projektit për subjektet që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.

Ministri, brenda 3 (tri) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim.

Nëse kërkesëpropozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit brenda 2 (dy) ditëve për nënshkrimin e kontratës.

Nënshkrimi i kontratës kryhet nga ministri ose një person tjetër i autorizuar prej tij.

1.Procesi i monitorimit të realizimit të Projektit të përzgjedhur kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të Projektit.

KËRKESË

Nr. 513, datë 25.1.2023

PËR SHPREHJE INTERESI TË KANDIDATËVE TË INTERESUAR PËR T’U ZGJEDHUR ANËTARË NË BORDIN DISIPLINOR TË DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, të ndryshuar, dhe të urdhrat të ministrit të Drejtësisë me nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor”, **Ministria e Drejtësisë shpall kërkesën për shprehje të interesit të kandidatëve të interesuar për t’u zgjedhur anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit të njërit prej 2 anëtarëve të cilët zgjidhen nga ministri i Drejtësisë.**

Kandidatët e interesuar për të qenë anëtar të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë duhet të plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në pikën 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, të ndryshuar, ku parashikohet, se:

“2. Kandidatët e zgjedhur sipas pikës 1 të këtij neni duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njënuar me të;



c) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;

e) të mos jenë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

e) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë.”

Në përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Disiplinor preferencë do të kenë kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore, ose kanë eksperiencë të provuar shkencore dhe/ose profesionale në çështjet e së drejtës civile.

Kandidatët e interesuar duhet të depozitojnë me postë ose dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë, apo në rrugë elektronike dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për shprehje interesi;

b) jetëshkrim;

c) kopje të mjetit të identifikimit;

e) diplomë që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;

d) vërtetim nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;

dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;

e) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë;

f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kriterëve ligjorë.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë është 10 ditë pas përfundimit të afatit të shpalljes.

Kandidatët e interesuar për të qenë anëtarë të Bordit Disiplinor të Noterisë nuk duhet të jenë anëtarë të Bordit të Auditimit, si dhe të organeve të tjera drejtuese të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative. Pas procesit të vlerësimit, secilin kandidat i njoftohet vendimmarrja, së bashku me relacionin e përgatitur për kandidatin.

Kandidatët e interesuar kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit, sipas pikës 11 të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020.

Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Vendimi për kandidatin fitues formalizohet me aktin përkatës administrativ të ministrit të Drejtësisë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës, dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe u komunikohet njëkohësisht kandidatëve fitues dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.

KËRKESË

Nr. 577/1, datë 26.1.2023

PËR SHPREHJE INTERESI PËR KANDIDATËT QË KËRKOJNË TË CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe në urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe në verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.



Trajtimi i shprehjeve të interesit dhe verifikimi i kriterëve ligjore të kandidatëve për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme kryhet nga struktura përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira në Ministrinë e Drejtësisë. Thirrja qëndron e hapur për një periudhë prej 15 ditësh nga data e publikimit.

Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit.

Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin si vijon:

a) Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;

b) Kopje të mjetit të identifikimit;

c) Certifikatë familjare;

d) Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë ose diplomë të lëshuar nga institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;

e) Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

f) Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;

h) Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjobë ose masë administrative, që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsëritë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

i) Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme; me urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 619, datë 23.11.2022, "Për përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e programit të detyrueshëm të

trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme", është vendosur se institucionet do të zhvillojnë trajnimin e detyrueshëm për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme janë: **KUB-i (Kolegji Universitar i Biznesit) dhe ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike).**

j) Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

NJOFTIM

Nr. 351, datë 30.1.2023

PËR SHPALLJEN E 2 (DY) VENDEVE VAKANTE PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor, me kategorinë e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master shkencor", në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, dhe të ketë marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;



- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur dhe për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumenteve: diplomë, letërnjoftim dhe librezë pune (origjinale ose të noterizuara);
- Dëshmi penaliteti;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe

trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 13.2.2023, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: “Ruga e Kavajës”, ish-godina “Lidhja e Shkrimtarëve”, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna-premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, që konfirmon marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2023